

## THE IMPACT OF ADEM DEMAÇI IN THE MOVEMENT FOR ALBANIAN RESISTENCE IN FORMER YUGOSLAVIA

**Fatmir Arifi<sup>1</sup>, Albulenë Halili<sup>2</sup>**

<sup>1</sup>*Can. PhD Instituti i historisë "Ali Hadri" Prishtinë*

*Email: fatmir.arifi@live.com*

<sup>2</sup>*Candite. PhD, Universiteti i Tiranës*

### Abstract

The study of such personalities, such as Adem Demaçi, with vision and integrity, with national political dignity and honesty, is just a viewpoint, entirely partial, or a view of a single aspect of the whole of the Demaçi political thought. The philosophical thought represented and distributed by Adem Demaçi represents an uneasy task for scholars of the philosophical thought theory. The Demaçi philosophy presents a comprehensive, deep and consistent mental logic system in itself.

Based on this spectrum, the aim of this study is built on the ideological orientation of Adem Demaçi related to the 1968 demonstrations, seeing his persona as one of the key figures beyond the fact that he was physically in prison in 1968.

**Keywords:** *Adem Demaçi, Demonstrations, philosophy, politics.*

## NDIKIMI I ADEM DEMAÇIT NË LËVIZJET PËR REZISTENCËN SHQIPTARE NË ISH-JUGOSLLAVI

**Fatmir Arifi<sup>1</sup>, Albulenë Halili<sup>2</sup>**

<sup>1</sup>*Can. PhD Instituti i historisë "Ali Hadri" Prishtinë*

*Email: fatmir.arifi@live.com*

<sup>2</sup>*Candite. PhD, Universiteti i Tiranës*

### Abstrakt

Studimi i personaliteteve të tilla, siç është Adem Demaçi, me vizion dhe integritet, me dinjitet e ndershmëri politike kombëtare është vetëm një këndvështrim, krejtësisht i pjesshëm, apo pamje e një aspekti të vetëm të tërësisë së mendimit politik demaçian. Mendimi filozofik që ka përfaqësuar dhe shpërndarë Adem Demaçi, përbën një detyrë jo të lehtë për studiuesit e teorisë së mendimit filozofik. Filozofia e demaçiane paraqet një sistem logjik mendor të gjithanshëm, të thellë dhe konsekuent në vetvete.

Nisur nga ky spektër, qëllimi i këtij punimi është ndërtuar mbi orientimin ideologjik të Adem Demaçit kur janë në pyetje demonstratat e vitit 1968, duke e parë këtë personalitet si një ndër figurat kyçë edhe përtej faktit se ai në vitin 1968 fizikisht ishte në burg.

**Fjalë kyçë:** *Adem Demaçi, demonstrata, filozofia, politika.*

Adem Demaçi nuk ishte vetëm ideolog i lëvizjeve të fshehta me karakter çlirimtar në hapësirën shqiptare të ish-RSFJ, por dhe themelues i shkollës së mendimit politik, e cila u bë bazë për të gjitha organizatat ilegale të mëpastajme.

Ndaj dhe studimi mbi mendimin filozofik të Adem Demaçit, përbën një detyrë jo të lehtë për studiuesit e teorisë së shkencave sociale. Filozofia e demaçiane paraqet një sistem logjik mendor të gjithanshëm, të thellë dhe konsekuent në vete.

Trashëgimia e tij shumëdimensionale është më e madhe se roli i tij historik në demonstratat e vitit 1968, por edhe të LBRSH-së, pesëdhjetvetorin e të cilave, po e shënojmë ne sot si ngjarje historike. E them këtë për një arsy: të shkruash për demonstratat e vitit 1968, por dhe për LRBSH, domosdoshmërisht, duhet t'i referohesh një date në kalendar. Ndërsa, të shkruash për Adem Demaçin, domosdoshmërisht, duhet t'i referohesh një epoke.

Secili studim për Demaçin, duke përfshirë edhe këtë, është vetëm një këndvështrim krejtësisht i pjesshëm apo pamje e një aspekti të vetëm të tërësisë së mendimit filozofik demaçian.

Idealet që i promovoi Demaçi, qoftë si individ, qoftë si ideolog dhe drejtues i LRBSH-së apo si personaliteti më me influencë në lëvizjet e mëvonshme çlirimtare, ende janë të vlefshme edhe sot.

Gjithanshmëria sistematike dhe konsekuenca mendore dëshmojnë se në historinë e filozofisë së pas Luftës së Dytë Botërore në hapësirën shqiptare, Adem Demaçi s'ka as paraardhës as trashëgimtar dhe kjo e shndërron atë në një mendimtar *sui generis*, dishepull i askujt<sup>1</sup>.

Me plot të drejtë, duke e studuar karakterin e tij shumëdimensional, në librin e tij, një nga studiuesit më të mirë të çështjes së Ballkanit, Jeams Pettifer, e radhit atë në rangun e një personaliteti të historisë botërore. Pas takimit të tij të parë me Demaçin në vitin 1991, pas daljes nga burgu, Pettifer shkruan:

*“Në një vend e në një jetë the ër ai do të kishte organizuar mbrojtjen e Parisit më 1870, a betejën e Dien Bien Fusë, ose do të ishte ngjitur deri te Komitetit qëndrorë i bollshevikëve, apo do të kishte marrë pjesë në Marshimin e Madh<sup>2</sup>”.*

Siq e dimë, këto katër ngjarje, që i specifikon Pettifer në librin e tij dhe jo rastësisht bënë një analizë krahasuese, janë katër ngjarje që kanë ndryshuar botën; janë ngjarje që kanë ndryshuar sisteme ndërkombëtare, janë ngjarje që kanë lënë gjurmë të përjetshme në historinë e njerëzimit; janë ngjarje që kanë krijuar krenarinë e kombeve përkatëse ku janë zhvilluar.

Adem Demaçi, si mendimtar, veprimtar, studiues, letrar dhe njëkohësisht i burgosur politik, si ka mundësi që përkundër asaj që emri i tij, siç shkruan në një studim të tij, profesor Hakif Bajrami: “përgjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit XX, ai ishte informata më e ndaluar në familjet shqiptare<sup>3</sup>”, në gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë dhe nga ana tjetër,

<sup>1</sup> Albulena Halili & Fatmir Arifi, “Filozofia Demaçiane e Amalgamës ideologjike Shqiptare”, ADEM DEMÇI- Ura mbi të cilën kalon liria e Kosvës, kumtesat e paraqitura në simpozumin shkencor në nderim të 80-vjetorit të lindjes së Adem Demaçit, Shoqata e të burgosurve politikë të Kosovës dhe Fondi “Nderi i Kombit -Adem Demaçi, f, 69, Prishtinë, Zurich, 21 shkurt 2016.

<sup>2</sup> Jeams Pettifer, Ekspresi i Kosovës, f, 56, New York 2006

<sup>3</sup> Hakif Bajrami, Adem Demaçi, lider i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Per me shume lexo:  
<http://fondiademdemaci.org/adem-demaci-lider-i-levizjes-kombetare-shqiptare/>

njëkohësisht ishte personaliteti më me ndikim në profilizimin, shtresëzimin dhe ngritjen organizatave në shërbim të çlirimtë hapësirës shqiptare në Jugosllavi?

Përgjigen në këtë pyetje, natyrisht mund ta jep shumë disiplina shkencore, por perspektiva historike thotë se Demaçi nuk i trajton problemet në mënyrë pëershkruese, por tek ai bashkohen zgjuarsia filozofike me aksionin politik - pra me atë të njeriut veprues.

Demaçi i jep shumë rëndësi sistematizimit të idesë, e cila konsiston në atë se filozofia pa sistem nuk mund të ketë në vete asgjë shkencore dhe objektive dhe për më tepër, si e tillë, ajo është ide e rastësishme e subjektive.

Andaj, studimi mbi Demaçin duhet të orientohet në dy rrafshet: në rrafshin e pragmatizmit politik, i cili është i determinuar nga rrethanat e kohës; dhe së dyti në rrafshin teorik, i cili është mendim tërësisht burimor i dalë nga tradita, kultura dhe historia e kombit të lashtë shqiptar!

### **Rrethanat dhe zhvillimet politike në hapësirën shqiptare**

Demaçi u lind në periudhën në mes dy Jugosllavive: të Versajës dhe atë të AVNOJ-it. Që të dy këto krijesa (e dyta trashëgoi të parën), ishin fryt i planifikimeve ekspansioniste dhe hegemoniste serbe. Ajo që nuk ishte përmبushur me Jugosllavinë e parë, synohej të plotësohej në të dytën!

Mirëpo, nga ana tjetër edhe në hapësirën shqiptare, që nga viti 1912, nga presioni i pandalshëm dhe intensiv i pushtuesve të tokave shqiptare, bëri që vetëdija kombëtare të fillonte të ngrihej në nivel organizimi të lëvizjeve të rezistencës, të cilat kishin efektin e vet politik të mospjimit me pushtuesin.

Falë rezistencës së disa organizatave politike kombëtare të herëpashershme, u bë e ditur edhe për vetë okupatorin, se këto toka nuk do të lëshohen dhe nënshtrohen aq lehtë siç mendohej dhe propagandohej nga qarqet jugosllave.

Kështu që mbi bazën e parimeve ekspansioniste dhe hegemoniste, në byronë politike të Jugosllavisë së AVNOJ-it u hartuan dhe u profilizuan dy projekt-veprime politike shumë specifike në marrëdhëni e shtetit jugosllav me shqiptarët në përgjithësi. Në projektin e parë u ravijëzua koncepti se:

*“shqiptarët nuk mund të na bëhen kurrë partnerë besnikë. Përveç që duhet mbajtur në armiqësi mes vete, ata duhet të mbahen në distancë as larg, as afér, por mjaftueshëm, kurdo që kërkohet për t'i vënë në ankand”.*<sup>4</sup>

Ky projekt lidhej me politikat nacionaliste, shoviniste dhe diskriminuese që ndiqte Jugosllavia kundër popullsisë shqiptare që jetonte në trojet e saj në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Siç është dokumentuar, nga studiuesi Bardhyl Mahmuti:

---

<sup>4</sup> Po aty: <http://fondiademdemaci.org/adem-demaci-lider-i-levizjes-kombetare-shqiptare/>

*“...në periudhën e luftërave për krijimin e shteteve kombëtare në këtë pjesë të Evropës u përpiluan vizione dhe projekte kombëtare, që kanë kushtëzuar funksionimin e shoqërive të kësaj hapësire për gati dy shekuj rresht<sup>5</sup>.*

*Ditet fare mirë se nuk mund të ketë mobilizim për krijimin e shtetit kombëtar pa pasur, paraprakisht, vizionin për hapësirën gjeografike, në të cilën duhet shtrihen kufijtë e shtetit përkatës.*

*Derisa në Evropën perëndimore karakteristikë e vetme në procesin e krijimit të shteteve kombëtare ka qenë politika ekspansioniste (shtrirëse), fillimisht vetëm ndaj territoreve të popujve fqinjë e më vonë në përmasa kontinentale e botërore, në Ballkan politika ekspansioniste shoqërohej me një politikë ekspulsioniste (debuese<sup>6</sup>).*

Përqendrimi i këndvështrimit në këtë aspekt ka rëndësinë vendimtare, sepse na mundëson të shohim bazën ideologjike të praktikave gjenocidale. Me një fjalë, vizioni për shtetin me hapësirë të madhe dhe “pa të tjerët” do të projektojë praktika të tillë që do të synonte, “spastrimin” e territorit nga etnitë e tjera.

Si rrjedhojë e këtij koncepti, lindi projekti nationalist grek, “Megali Idea”, i cili do të përfundojë me spastrimin etnik dhe gjenocidin mbi shqiptarët e Çamërisë, kurse projekti për “Serbinë e Madhe” (që fillon me projektet e Ilia Grashaninit, Vasa Çubrilloviqit, Ivo Andriqit, Ivan Vukotiqit, Stevan Moleviqit e deri te Memorandumi i ASSHA), do të realizojnë spastrimin etnik të Sanxhakut të Nishit dhe do të përgatitnin krimet kundër njerëzimit dhe politikën e Gjenocidit në Kosovë.

Përqendrimi i vëmendjes në vizionet për hapësira shtetërore të “Mëdha” na ndihmon që të kuptojmë arsyet e praktikave të shpeshta të gjenocidit, që kanë ushtruar Greqia, Serbia, etj., në periudha të ndryshme ndaj popujve fqinjë në përgjithësi dhe ndaj shqiptarëve në veçanti. Kjo qasje ka rëndësi të veçantë, sepse hedh poshtë interpretimet që synojnë të shpjegojnë politikat e gjenocidit vetëm si pasojë e regjimeve antidemokratike të Athinës, Beogradit etj. Siç është faktuar, në këto periudha historike, që nga 1870, viset shqiptare ishte shndërruar në një rezervat kolonial ekonomik për Serbinë dhe më vonë edhe për Jugosllavinë. Këtij kolonizimi e prapambetjeje ekonomike të shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi i shtohej edhe politika diskriminuese që ndiqej ndaj tyre në fushën e arsimit, kulturës dhe shkencës, ndaj të drejtave dhe lirive kombëtare e njerëzore në krahasim me kombet dhe popujt tjerë në Jugosllavinë e pas 1945!

Politika e shtetit jugosllav qoftë para Luftës së Dytë Botërore, qoftë e pas Luftës së Dytë Botërore, ndaj shqiptarëve kishte mbetur e pandryshuar në synimet e saj shkombëtarizuese anti shqiptare: *ekspansioniste dhe ekspulsioniste*. I ashtuquajturi “socializëm vetëqeverisë”, Tito realizonte njëherazi shpopullimin masiv për shqiptarët jashtë Jugosllavisë si dhe shpërndarjen e tyre në tre republika, që në fakt është komplementar me projektin e dytë, i cili konsiston në marrjen e hapave për të copëtuar edhe më tej hapësirën shqiptare në tri shtete, përkatësisht në tri republika federative.

---

<sup>5</sup> Bardhyl Bahmuti, më datë 21 Mars, 2011, në ditën ndërkombëtare për luftën e eliminimit racial në botë, publikon platformën “*anti-diskriminim e shqiptarëve në Maqedoni*”, në të cilën nxjerr haptazi të gjitha format e diskriminimit racor që shteti IRJM aplikonte kundër shqiptarëve. Për më shumë lexo:

<https://issuu.com/platforma/docs/platforma>

<sup>6</sup> Po aty.

Përcopëtimi i hapësirës shqiptare kishte një qëllim të vetëm: të eliminonte të drejtën e shqiptarëve, në ish-Jugosllavi që të quheshin komb, duke e transformuar nacionin popull në nacionin pakicë kombëtare.<sup>7</sup>

Padyshim, pushteti jugosllav e dinte se nacioni popull sipas Kartës së Atlantikut<sup>8</sup>, por edhe sipas Kartës së OKB-së do t'ua mundësonte shqiptarëve të drejtën e shprehjes së vullnetit për organizim shtetëror - të drejtën për vetëvendosje.

Loja e ndryshimit të nacionit do të jepte efektin e vetë tragjik për shqiptarët. Kjo djallëzi politike sllave u dëshmua qartë në vitet '60, kur në OKB u aprovua rezoluta për dekolonizimin e tokave të okupuara, sipas së cilës "vetëm komet kanë të drejtë për vetëvendosje"<sup>9</sup>, por jo edhe kombësitë!

Përmes kësaj politike, Jugosllavia, krahas tendencës së dobësimit, synonte edhe shthurjen e kombit shqiptar duke stimuluar përçarjen dhe armiqësitë brenda shqiptarëve, angazhime tepër të dyshimta, "integrame dhe riintegrame" që ishin në shërbim të copëtimit dhe ricopëtimit të hapësirës së shqiptarëve.

Përkundër angazhimeve dhe përpjekjeve të shumta, pas përfundimit të LDB-së, çështja shqiptare mbeti e pazgjidhur. Të gjitha kontributet e angazhimit të popullit shqiptar të Kosovës, në luftën antifashiste, nuk iu njohën! U shkelën shumë rezoluta ndërkombëtare dhe marrëveshje të llojit të marrëdhënieve të brendshme siç ishte ajo e Konferencës së Bujanit<sup>10</sup>.

---

<sup>7</sup> Pas përfundimit të Luftës së Dytë botërore, territoret shqiptare i ndanë midis tri republikave jugosllave. Në kuvendin e Prizrenit, më 1945 u deklarua se Kosova "shpall me vullnetin e popullit të saj", se ajo i bashkohet Serbisë në kuadër të Federatës jugosllave. Ky vendim ishte në kundërshtim me Rezolutën e Bujanit të 31 dhjetor 1943 - 2 janar 1944. Në këtë kuadër, në Kosovë më 8 shkurt 1945 u instalua regjimi ushtarak për ta mbrojtur vendimin e Kuvendit të Prizrenit. Regjimi ushtarak jugosllav, kishte detyrë të veçantë për të paralizuar dhe shuar shprehjen e pakënaqësisë për zgjidhjen e padrejtë të statusit të popullit shqiptar dhe hapësirave të tij. Ishte e kuptueshme se populli shqiptar nuk u pajtua dhe nuk do të pajtohet me vendimin e tij për të qenë nën robëri. Prandaj, njëri nga parimet e programit politik të Lëvizjes që drejtonte Adem Demaçi, qe kundërshtimi i këtij vendimi.

<sup>8</sup>Karta e Atlantikut është marrëveshje parimesh baze mbi rendin e ri botërorë të ardhshëm. Ky takim u mbajtë fillimi i mes të F.D Rooseveltit dhe W. Churchilt, në një anije luftarake "Princi i Uellsit" e ankoruar pranë ishullit Terranova, në Oqeanin Atlantik, prej dates 9 deri me 12 gusht te 1941 dhe u shpall më 14 gusht të vitit 1941.

Kësaj marrëveshje, më 24 shtator të vitit 1941 në Londër iu bashkëngjitet edhe: Belgjika, Çekoslovakia, Greqia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia, Franca. Me këtë marrëveshje është miratuar njëzëri aderimi në parimet e politikës së përbashkët të përcaktuara në këtë Kartë. Kjo marrëveshje nijitet dhe si aleanca kundër fashizmit. Karta e Atlantikut përpiloj projektin për botën pas Luftës së Dytë Botërore, dhe është bazë i shumë traktateve ndërkombëtare dhe i organizatave ekonomike-politike, që i dhanë formën e saj strukturore e funksionale. Dy nga dhjetë pikat e trajtuara janë: "Territorët duhet të jenë në përputhje me pretendimet e popujve qe kane probleme te ngatërruara nga padrejtësitë historike", "U lind e drejta të gjithë popujve për vetëvendosje". Për më shumë lexo: <http://avalon.law.yale.edu/wwii/atlantic.asp>

<sup>9</sup>Declaration on the Granting of Independence to Colonial Countries and Peoples, Adopted by General Assembly resolution 1514 (XV) of 14 December 1960. Marrë nga: <http://www.un.org/en/decolonization/declaration.shtml>.

<sup>10</sup>Konferencia e Bujanit është mbajtur më 31 dhjetor 1943 e deri më 2 janar 1944, si rikonfirmim i rrethanave të reja të krijuara pas Mbledhjes së Mukjes dhe Konferencës së Pezës si rezultat i mospërfshirjes së Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nën sundimin e ish-Mbretërisë SKS, e cila u mbajt pikërisht për t'i kundërshtuar

Për më tej, Kosova dhe viset shqiptare u vendosën nën regjimin ushtarak dhe në shkurt të vitit 1945, filloj ploja e madhe për të eliminuar të gjitha forcat e rezistencës, të cilat po luftonin që Kosova t'i bashkohej Shqipërisë.

Fillimisht këtyre politikave anti shqiptare dhe diskriminuese që janë të lidhura me ripushtimin e Kosvës iu kundërvu Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH). Mirëpo, rrethanat gjeopolitike, kishin prodhuar konfigurime jo të favorshme, me ç'rast LNDSH-ja kishte mbetur pa përkrahje të jashtme dhe i gjithë potenciali i saj ishte bazuar te vetvetja.

Pra në këtë fazë në pah dalin dy koncepte: njëra që luftonte për ripushtimin dhe rikolonizimin e hapësirës shqiptare dhe njëra që luftonte për çlirim e tokave shqiptare në ish-Jugosllavi dhe bashkimin e tyre me shtetin amë.

Këto dy koncepte, me vite të tëra e luftuan njëra-tjetrën pa kompromis, ndonëse koncepti jugosllav, në këtë periudhë, ishte në një situatë më të favorshme. Ky koncept ka vazhduar të jetë gjallë edhe pas shuarjes së NDSH-së në periudha të mëvonshme.

Natyrisht me këtë lëvizje janë të lidhura lufta e Ferizait, Gjilanit, Mitrovicës dhe ajo e Drenicës<sup>11</sup>. Por vlen të theksohet se ripushtimit të Kosovës, politikave të persekutimit, eksplorimit, stigmatizimit të pas Luftës së Dytë Botërore, iu kundërvunë edhe organizata të tjera, me orientime, kombëtare, siç ishin: organizata “Bashkimi Shqiptar<sup>12</sup>”, grupi i Njazi Malokut<sup>13</sup>, Grupi i Aziz Spahisë<sup>14</sup> dhe Grupi i Gjakovës<sup>15</sup>, të cilat sipas aktakuzës,

---

vendimet e Mbledhjes II të AVNOJ -it në Jajcë (29-30 nëntor 1943) dhe mospërfshirjes së Kosovës si subjekt i pavarur që deri atëherë ishte përfshirë përmes Malit të Zi në KAÇKJ .

Në këtë konferencë u miratua rezoluta përfundimtare, ku thuhet : “*Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit është krahinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot, dëshiron me u bashkue me Shqipërinë*”. Formulimi i një qëndrimi të tillë mbështetej në vetë deklaratat e PKJ-së dhe të KANÇ-it të Jugosllavisë, në të cilat njihej parimi i vetëvendosjes së popujve deri në shkëputje, parim bazë ky i Kartës së Atlantikut, i shpallur solemnisht nga aleatët e koalicionit antifashist.

Më poshtë në rezolutë theksohet se: “*Lufa e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjaksuer e rrogtarëve të tij, është e vetmja rrugë për me fitue lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe populli shqiptar, do të kenë mundësi me vetëvendosë mbi fatin e tyre, me të drejtën e vetvendosjes deri në shkëputje*”. Garant për këtë është UNÇ e Jugosllavisë dhe UNÇSH e Shqipërisë, me të cilën është ngushtësisht e lidhur. Parimet e kësaj rezolute të aprovuar janë tërësisht të mbështetur në Kartën e Atlantikut, Konferencën e Moskës dhe asaj të Tehranit.

<sup>11</sup> Haxhi Ademi, “Interpretimi i literaturës historiografike shqiptare për ripushtimin jugosllav të Kosovës dhe Luftën e Drenicës (1944/1945)”, *Ripushtimi jugosllav i viseve shqiptare dhe Lufa e Drenicës (1944/1945)*, (Prishtinë: Instituti i Historise “Ali Hadri” Prishtinë, 2016), 277-298.

<sup>12</sup> Këtë organizatë e përfaqësonte Konstantin Vasilika, i cili, sipas aktakuzës të organeve shtetërore jugosllave, ishte pjesëtar i shërbimit sekret shqiptar. Ai kishte për mision mbledhjen e informacionit që kishte të bënte me forcat e armatës jugosllave, si dhe krijimin e organizatave që do të punonin në rrëzimin e rendit shtetëror të Jugosllavisë. Organizatës “Bashkimi Shqiptarë”, sipas aktakuzës i takonin dhe anëtarë të tjerë, si Xhemë Latë Spahiu, Hajrullah Gorani, Hamdi Devollli, Rashit Gorani, Ramë Geca etj,etj. Për më shumë, shih: Aktakuzën: Prokuroria publike e Qarkut , K Nr. 74/56. KTO Nr.116/56, Prizren, 08.VI.1956.

<sup>13</sup> Sipas aktakuzës, këtij grupi i takonte: Nijazi Maloku, Rexhep Muhadri, Demush Cahani, Shani Hoxha, Imbrahim Moni, Hasan Bajrami, Sedat Dida dhe Muhamet Emini. Po ashtu edhe ky grup u dënuar me të njëjtën aktakuzë për spinazh që ishin të lidhur me sigurimet shtetërore shqiptare, Po aty.

<sup>14</sup> Ky grup i organizuar përbëhej nga: Aziz Spahia, Hasan Berisha, Reshat Hadri dhe Durak Pasuli. Po ashtu edhe ky grup u dënuar si organizatë që punonin për llogari të sigurimit të shtetit shqiptar, të cilët kishin për qëllim të organizonin kryengritje të përgjithshme për ndarjen e Kosovës nga Jugosllavia dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Shih aktakuzën: Prokuroria publike e Qarkut , K. Nr. 74/56. KTO Nr.29/59, KTO Nr. 6/59. 19 shkurt 1959, Prizren, 19.II. 1959, Gjykata e Qarkut, Prizren.

<sup>15</sup> Po aty, f. 258. Për më tej, sipas aktakuzës grupin e Gjakovës e përbëjnë: Muhamet Brovina, Adem Krasniqi, Gjon Shtufaj, Besnik Koci dhe Hida Dobruna, të cilët akuzohen se në vitin 1957, në disa lagje të Gjakovës kanë ngritur flamurin kombëtar shqiptar si dhe kanë shkruar parulla me përbajtje armiqësore

që u trajtuan dhe dënuan pas dekospirimit, nga organet e OZN<sup>16</sup>-as si grupe të lidhura me sigurimin shteror të Shqipërisë.

Po ashtu dhe organizatat e si: "Partia Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë", të udhëhequr nga Metush Krasniqi dhe "Komiteti për Bashkimin e Trojeve Shqiptare", të cilën e drejtonte Ali Aliu, nga Presheva dhe Kadri Halimi, nga Gjilani, në fund të viteve pesëdhjeta do të arrestohen ashtu siç arrestohet dhe Adem Demaçi, për shkak kundërvënie haptas së tendencës ekspansioniste me shkrimet e tij të botuar në revistën Jeta e re! (Gjarpërinxhja e Gjakut)

Pas daljes nga burgu më 18 nëntor 1961, Adem Demaçi, duke e parë se gjendja e popullsisë shqiptare në ish hapësirën e Jugosllavisë, e cila ishte po ajo e viteve 50-ta, pa asnje lloj ndryshimi pozitiv, vendosi të konkretizojë idenë për krijimin e një organizate me karakter çlirimtar.

Së bashku me veprimtarët e patriotët si Ramadan Shala, Mustafë Venhari, Fazli Grajçevci, Rexhep Elmazi, Kadri Kusari, Dinë Spahiu, Bedri Çollaku, Ahmeti Haxhiu, Zeqir Gërvalla e shumë të tjera, formojnë organizatën "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve"<sup>17</sup>.

Natyrisht, krijimi i LRBSH, jo vetëm që krijoj një kapitull të ri<sup>18</sup> në organizmin klandestin, por si organizatë u bë bazë për tërë organizimin e mëvonshëm ilegal<sup>19</sup> në Kosovë. LRBSH-

---

kundër Jugosllavisë. Në aktakuzë, nuk theksohet se ky grup organizativ ka pasur lidhje me Sigurimin e Shtetit Shqiptar.

<sup>16</sup> Sqarim. "Duke pasur si model ÇEKA-n ruse, Partia Komuniste Jugosllave me 13 maj 1944, themeloi, shërbimin sekret OZNA (Odsek za Zaštitu Naroda - sektori për mbrojtjen e popullit). Që nga themelimi i tij e deri në vitin 1966, Tito do ta vendllos Aleksandar Rankoviqin si udhëheqës të këtij shërbimi. Kjo datë, (13 maji) do të shënojë datën e themelimit të këtij aparati dhune në Jugosllavi, që për një kohë të shkurtër do të veproj pamëshirshëm tek të gjithë popujt që jetonin në shtetin jugosllav, e në veçanti te populli shqiptar. Që nga shtatori i vitit 1944 e deri në fund të këtij vitit 1945, nën akuzat e "antikomunizmit ekstrem "u ekzekutuan me dhjetra mijë shqiptarë. Zyrtarisht vetëm në Kosovë u ekzekutuan pa gjyq 17400 shqiptar. Për të gjitha këto veprime, nga një pjesë e inteligjencës në Kosovë thuhet se Tito nuk i ka ditur këto ngjarje. Duke pasur parasysh të gjitha postet e përmendura më lartë për Titon, si dhe faktin se si funksioninë institucionet e një shteti monist, është e pamundur që të mos ketë pasur njohuri Tito. Për më shumë lexo: Bedri Halimi, *Antishqiptarizmi i Josip Broz Titos*. Per me shume lexo: <http://ekonomika.com/sq/opinion/antishqiptarizmi-i-josip-broz-titos>, vizituar me date 25 nëntor 2018.

<sup>17</sup> Ramadan Avdiu, "Ndikimi i Adem Demaçit dhe LRBSH në organizimin ilegal", ADEM DEMÇI- Ura mbi të cilën kalon liria e Kosovës. Kumtesat e paraqitura në simpoziumin shkencor në nderim të 80-vjetorit të lindjes së Adem Demaçit, Shoqata e të burgosurve politik të Kosovës dhe Fondi "Nderi i Kombit -Adem Demaçi, f, 177, Prishtinë, Zurich, 21 shkurt 2016.

<sup>18</sup> Po aty, f, 177.

<sup>19</sup> "Kohëve të fundit si në shkencë njashtu edhe në publicistikë, si në media të shkruara njashtu edhe në ato elektronike, është krijuar një laramani përdorimesh të termeve si: ilegale, klandestine dhe e fshehtë. Lëvizjet tona kombëtare, për shkak të ndjekjeve të vazhdueshme, që i bënин regjimet pushtuese ato ishin të detyruar që të vepronin në një konspiracion të thellë. Dhe mu nga kjo, për shkak se njerëzit që vepronin në to, vepronin ilegalisht dhe binin ndesh me ligjet dhe rregullat e atij shteti, në popull dhe nga pushtetarët filluan të quhen dhe të bëhet e rëndomtë shprehja: Lëvizje Ilegale, Lëvizjet Klandestine, Lëvizjet e Fsheta, por që të gjitha kishin karakter të Lëvizjeve Patriotike dhe Clirimtare etj. Në gjuhën shqipe fjala "ilegale", si nocion apo term, ka marrë prej kohësh të "drejtënytetare", dhe është ngulitur në fjalorin e ligjërit të përditshëm dhe, në atë shkencor e studiues. Ky nocion, me kohë u kuptua si formë e veprimit dhe e organizimit të organizatave, grupeve e individëve që vepronin për çështjen e pazgjidhur kombëtare shqiptare. Për më shumë lexo fjalorin e shqipes, , Botim i Toenës, Tiranë, 2002. f. 500. ---Illegal,-i m.sh. -Ë, ËT. Ai që lufton kundër rendit në fuqi, duke jetuar e vepruar në fshehtësi të madhe; ai që zhvillon veprimtari politike të fshehtë. Jetë ilegali. Strehë (bazë) për ilegalët, dhe

Illegal, E, mb. 1. Që jeton, vepron e lufton si ilegal; që bëhet fshehurazi organeve qeveritare të një vendi; që është i fshehur e që s'duhet ta dinë të tjerët; kundër legal. Mbledhje (veprimtari, punë, luftë) ilegalë.

ja gjeti shtrirje në tërë hapësirën shqiptare dhe programi i saj u shpërnda dhe u mirëprit nga të gjithë atdhedashësit.

Një masovizim i tillë, përvèç anëve pozitive, e cila pak a shumë gati sa që arriti të shndërrohet në lëvizje masash<sup>20</sup>, bartte në vete dhe riskun e dekonspirimit të organizimit. Andaj më 1964, mbi 300 anëtarë të LRBSH u dekonspiruan dhe u arrestuan së bashku me Adem Demaçin. Ndonsë pati shumë anëtarë të LRBSH të arrestuar dhe të dënuar, pati dhe shumë të tjera që mbetën jashtë burgjeve dhe vazhduan forcimin e organizimit të fshehtë. Anëtarët dhe fryma programore e LRBSH-së, organizoi demonstratat e vitit 1968<sup>21</sup>.

Pa dyshim, përkundër që në këtë kohë, Adem Demaçi ishte në burg, kudo demonstruesit brohorisnin emrin e tij. Përkundër se emri i Adem Demaçit nuk përmendej publikisht, sepse çdo apostrofim i tij do të thoshte rrezik për burgosje, por shumë prej veprimtarëve betimin e bënин para flamurit dhe fotos së Adem Demaçit<sup>22</sup>.

Se sa ndikonte dhe sa ishte i pranishëm emri i Adem Demaçit në organizimin ilegal, më së miri e dëshmojnë brezi i viti 1981-1984, 1987-1988, 1991-1997!

Megjithatë, duhet të theksojmë se viti 1968, ishte viti i demonstratave në të gjithë hapësirën kontinentale të Evropës. Por këto demonstrata dallonin me organizimin e LRBSH-së! Analiza që duhet të shtrojmë është se: ku qëndron dallimi i 68' shqiptare me ato të 68' evropiane?

### Demonstratat nepër Europë dhe dallimi i tyre me 68 shqiptare

Viti 1968 ishte vit i lëvizjeve të mëdha politike në kontinentin evropian, i cili njihet si viti i lëvizjeve studentore. Siç shprehej njëri nga drejtuesit e lëvizjes ilegale me karakter çlirimtar dhe i demonstratave të vitit 1981, Hydajet Hyseni:

*"Ndonëse Europa ishte e ndarë, lëvizjet studentore përfshin dy gjysmat e ndara evropiane, të cilat ishin të ndara jo vetëm në hapësirë, por dhe në ideologji të kundërtë. "Çuditërisht, që të dy anët e ndara, për më tej dhe të kundërtë, admironin njëra-tjetrën. Por që të dyja ishin të pakënaqura dhe secila anë i ofrohej tjetrës si alternativë e vetme dhe pranohej deri në një farë mase nga pala tjetër. Lëvizjet rinore euro-perëndimore, ishin gati të hiqnin dorë nga "bota e lirë e demokratike, nga shoqëria e konsumit dhe të ekonomisë së tregut të lirë, në favor të "parajsës" tjetër "pa shtypje, pa shfrytëzim e tëhuajsim të njeriut, me barazi e siguri të plotë sociale. Ndërsa rinia eurolindore, ishte e gatshme t'i jepte të gjitha këto vetëm për një copëz të "parajsës", të luksit, bollëkut e lirisë pa kufi, në anën perëndimore të perdës<sup>23</sup>.*

---

Jetë ilegale. Bazë (qendër, shtypshkronjë) ilegale. Në mënyrë ilegale. 2. Që është i ndaluar me ligj, që është nxjerrë jashtë ligjit etj..." Për një studim më të zgjëruar lexo: Sabile Keçmezi- Basha: Çështje të përdorimi të nocioneve: ilegale, klandestine dhe e fshehtë, 08.12.2009, <http://www.zemrashqiptare.net/news/11703/rp-0/act-print/rf-1/print.html>; si faqe eshte konsultuar dhe ne nentor te viti 2018.

<sup>20</sup> "Lëvizja e masave", është formë e veprimit të gjërë shoqëror që bëhet për qëllime të rëndësishme, e cila ka për synim organizimin e masave të gjëra shoqërore. Për më shumë lexo: Fjalor i gjuhës së Sotme Shqipe, fq. 988, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë- Institut i Gjuhës së Letërsië, Tirana 1980.

<sup>21</sup> Ramadan Avdiu, op.cit, fq. 178.

<sup>22</sup>Po aty, fq. 179.

<sup>23</sup> Hydajet Hyseni, "Brezi i Ndryshimeve Historike", Demonstratat e vitit 1968, Vëllimi I, (:Instituti Albanologjik I Prishtinës&Shoqata e Të Burgosurve Politik), fq. 9, Prishtinë 2012.

Për më tej ai shkruan:

*“Të parëve, si thoshin gjë tanket në Pragë<sup>24</sup>, por as të dytëve s’u bënte fort përshtypja e breshërisë së bombave në Sajgon”. “...Demonstrata të tilla në vitin 1968 pati dhe në Beograd, por si askund tjetër, në Beograd demonstrata gjeti shprehje dhe tone shovenizmi, revanshizmi e despotizmi rankoviçist<sup>25</sup>.*

Por cilat ishin shkaqet e lëvizjeve rimore në Europën perëndimore në vitin 1967-68 që filluan në Francë, Gjermani, Itali, Spanjë dhe ku qëndron dallueshmëria e tyre me 68-tën shqiptare?

Nga një analizë e kujdeshme e të gjitha këtyre lëvizjeve, por t’i analizojmë: qëllimet, idetë, parullat, takтикat dhe mjetet e përdorura gjatë tyre; për më tej kategoritë shoqërore dhe politike që u përfshinë dhe pasojat që ato lanë, arrijmë në një konkluzion se përse ishin shkaqet kryesore të tyre. Ti marrim gjërat një nga një në këtë analizë krahasuese!

Së pari, përkundër asaj që në shtetet evropiane kishte një zhvillim ekonomik të ndjeshëm, ekzistonte një hendek i dukshëm në mes të aspiratave ideale dhe romantike në raport me zhvillimin ekonomik. Këtë hendek, rinia evropiane u përpinq ta plotësonë duke kërkuar modele lëvizjesh shoqërore, që në fakt ishin fare larg realiteteve. Dhe nga të gjitha lëvizjet jashtë evropiane, kjo rini studentore thithë vetëm fryshtë romantike të produktit të lëvizjeve shoqërore në botë. Duke qenë më një fryshtë të tillë, me baza romantike, atmosferë emocionale, këto lëvizje tërhoqën kryesisht moshat më të ndjeshme ndaj tyre: rininë! Por lanë jashtë moshat më racionale të shoqërisë. Lëvizjet me bazë romantike emocionale, zakonisht nuk kanë program politik dhe nuk ofrojnë asgjë të re për ndryshim, zhvillim dhe progres. Ndaj dhe u fikën pa nxitur mendime e alternativa të reja në të ardhmen. Me të drejtë studiuesi Ulter Laker shprehet se:

*“...lëvizjet romantike gjithmonë bazohen më tepër në atmosferën që krijohet se sa në një program të caktuar<sup>26</sup>”.*

Së dyti, demonstratat e rinisë evropiano-perëndimore u nxitën dhe u fryshtuan ndjeshëm edhe nga lëvizjet revolucionare në vendet e botës së tretë. Këto vende të botës së tretë ishin të përfshira në një valë lëvizjesh komplekse me karakter antikolonial dhe politiko shoqëror. Këto shtete të kolonizuara kishin një lidhje politiko-ekonomike me shtetet perëndimore, të cilat ishin koloni për shekuj me radhë dhe natyra, procesi i shkolonizimit, ishte krejtësisht revolucionare që e shoqëronin këtë proces! Për shembull, simbolet që i prinin këtij procesi, idealet që udhëhiqnin për rininë evropiane, përbënин një fryshtë të dukshme romantike e sidomos për rininë e vendeve perëndimore.

Së treti, lëvizjet që nisen në SHBA me motivë anti luftës së Vietnamit, u bënë motive dhe për rininë evropiane. Motivi kundër luftës në Vietnam herë herë mori trajta të një

<sup>24</sup> Në vitet e 60-ta, me ardhjen në pushtet të Brezhnevut, u shtrënguan ndaj prirjeve liberale të Çekoslovakisë. Çekoslovakia ka qenë një gjatë gjithë kohës një vend i dyzuar për së brendshmi gjatë periudhës komuniste. Por, nga tradita e saj e vjetër, Çekoslovakia ishte vendi i vetëm në Evropën qendrore, e cila ka përfaqësuar realisht tradita demokratike dhe orientim konstant perëndimorë. Të frikësuar nga kjo traditë properëndimore të Çekoslovakisë, e sidomos pas ardhjes në krye të saj të Dubcekut, i cili gjeti mbështetje të gjërë te masat dhe te shtresa intelektuale për një kurs më liberalizues, Pakti i Varshavës ndërhyri ushtarakesh më 21 gusht të vitit 1968 duke e pushtuar Çekoslovakianë dhe duke e ndryshuar tërësisht strukturën drejtuese të saj. Kjo ngarje në historiografi ka hyrë me termin “Pranvera e Pragës”. Këtij pushtimi sovjetik ndaj sovranitetit të tyre iu kundërpërgjigjën qytetarët qytetarët me rezistencë paqësore dhe passive. Trupat sovjetike ishin tepër të zhgënjer ku në të gjitha rrigët e qytetit ishin vendosur shenjat e komunikacionit mbrapsh me mbishkrim “Moskë”, si shprehje për tu larguar nga vendi.

<sup>25</sup> Hydajet Hyseni, op, cit, “*Brezi i Ndryshimeve Historike*”, fq. 9, Prishtinë 2012

<sup>26</sup> Ulter Laker, Evropa në Kohën Tonë, fq. 289, Tiranë, 1996

antiamerikanizmi të dukshëm e sidomos në Francë, ku golizmi<sup>27</sup> kishte krijuar një bazë politike të qëndrueshme paraprirëse antiamerikane.

Ndërsa, dallueshmëria e demonstrative të vitit 1968 në Kosovë me ato që po zhvilloheshin në vendet evropiane ishte thelbësore. Përveç tjerave, kërkesat ishin krejtësisht të ndryshme, struktura shoqërore po ashtu, parollat e demostratave të 68-tës shqiptare kishin një diferencë substanciale nga ato që po zhvilloheshin ne vendet evropiane.

Demostratat e viti 1968 në hapësirën shqiptare kishin karakter politiko- progresiste, që në thelb ishin kombëtare dhe anti koloniale. Për dallim nga demostratat e rinisë evropianiste të vitit 1968, në Kosovë u përdor dhuna policore dhe pati të burgosur e të dënuar politik.

Kërkesa “kërkojmë bashkimin e viseve të tjera shqiptare me Kosvës”, në bosht të saj kishte demaskimin e vendimeve të Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar të Jugosllavisë që ishte mbajtur në Jajcë në nëntor të vitit 1943. Siq dihej tani më në këtë mbledhje populli dhe viset shqiptare, përveç që nuk ishin pjesë e kësaj mbledhjeje, u përdorën për të rregulluar përmasat demografike dhe territorial të republikave të Federatës, e sidomos të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Në Jajcë Tito e pati menduar që të gjithë pakënaqësit, orekset, ambiciet e interest serbe, maqedone dhe malazeze ti plotësonte me territorë dhe popullsi shqiptare. Kjo ndarje e shqiptarëve në tri republika për Titon kishte disa vlera: së pari kënaqte nga pak tre nacionalitetet sllave agresive; së dyti, fragmentarizonte faktorin shqiptarë duke shmangur homogenizimin e tij në një strukturë federale me vehte; së treti, pamundësonë që në sferën ndërkombëtare, shqiptarët të quhen komb, por statusi i tyre të trajtohet si kombësi<sup>28</sup>.

Prandaj dhe kërkesa e demostratave të vitit 1968 nën drejtimin e LRBSH-së siç ishte: “Vetvendosje..., Republikë...”, përvèc që ishte kërkesë në shërbim të së drejtës së popullit shqiptarë, po ashtu demaskoi dhe skemën djallëzore të Titos për fragmentarizimin e popullsisë shqiptare. Këto kërkesa, që nga viti 1968, janë bartur me shumë sakrifica edhe në gjeneratën dhe proceset e më vonshme. Kjo kërkesë kurdo dhe ku do që është prezantuar është shtypur egërsisht nga shteti serb, por dhe në vehte ka bartur dhe moskuptime, indiferencë dhe cinizëm nga një pjesë e konsiderueshme të asaj që quhet “bashkësi ndërkombëtare.

### **Filozofia demaçiane e harmonisë si filozofi e mbijetesës**

Përballja me gjithë këto procese të dëmshme ndaj tërësisë shqiptare, me padrejtësi të mëdha, që në rinin e tij e nxitën Adem Demaçin të vendosë idenë e madhe të fjalës, të pajtimit dhe të zhdukjes së antagonizmave të përbrendshëm. Fillimi shtëpianët në romanin e tij “Gjarpërinjtë e gjakut”,<sup>29</sup> e më vonë dhe në platformën e LRBSH<sup>30</sup>, ai nxori në sipërfaqe

<sup>27</sup> Gjenerali De Gol, prej kohësh kishte krijuar një dorktrinë të bazuar në ineteresat nationale të Francës. Pavarësisht situatave të krijuara, pavarsishte impakteve në përplasjen ideologjike-Lindje-Perëndim, De Goli mbajti linjën e tij që shumë studiues e trajtuan si linjë antiamerikane, por në fakt ajo ishte linjë në interesa nationale.. Për një lexim të më tejmë lexo: J.B. Duroselle, Europe and the History of its Peoples, Viking, 1990, fq. 402.

<sup>28</sup> Sipas dokumenteve dhe akteve ndërkombëtare, të drejtën e vetvendosjes mund ta përdorin vetëm kombet, jo dhe kategorite e tjera shoqërore.

<sup>29</sup> Romani “Gjarpërinjtë e gjakut” lajtmotiv ka gjakmarjen si një institucion të trashëguar që zbatohet si rrjeti i kanunit, në mungesë të shtetit amë si organizim më i lartë i një kombi. Kjo masë juridike, në kohën kur Demaçi shkroi romanin e lartpërmendur kishte marrë përmasa të paparashikueshme tragjike, si akt i vetëfljimit i veshur me petkun e rrejshëm të aktit heroik. Kjo plagë e madhe, si çdo tjetër, shfrytëzohej nga regjimi jugosllav dhe përdorej si mjet efektiv i politikës së tij spastruese e shfaruese ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Ky roman, qe ndër kumtet e këmbanat e para që binin për një zgjim të ri kombëtar. Porosia e

idenë e harmonisë njerëzore dhe asaj kombëtare si faktor themelor i të gjitha forcave ekzistuese në luftën e të kundërtave. Duke qenë se teoria e harmonisë është faktori themelor i të gjitha forcave ekzistuese në luftën e të kundërtave, atëherë, vetëm përpjekjet janë ato që përcaktojnë integritetin e një gjëje apo të një procesi. Harmonia njerëzore, sipas Demaçit, ishte kodi i aspiratës së pajtimit dhe bashkimit, e cila e sfidon esencialisht një kohë dhe një realitet përplot injorancë.

Si njohës i thellë i ligjeve të natyrës, ai e dinte se çdo qenie, dhe si pasojë e gjithë bota në tërësi është një shumëllojshmëri e të kundërshtuarit të forcave, andaj pikërisht duke luftuar tendencat e të kundërtave, arrihet uniteti. Harmonia demaçiane bazohet në një shumëllojshmëri kontekstesh, e cila arrihet duke mos harruar rrugën kryesore për t'i arritur qëllimet; duke njojur potencialet tonë të brendshme shpirtërore dhe duke përvetësuar tërë përvojën jetësore, qoftë kjo edhe nëpër burgje; duke luftuar me vetveten; duke kaluar dhimbjet e mëdha individuale e familjare,<sup>31</sup> sentimentet e ndryshme në favor të vlerave më të mëdha kolektive; duke e mbrojtur vetveten nga vetja; duke ndryshuar veten, shokët dhe shumicën<sup>32</sup>; duke hequr stihinë<sup>33</sup> nga jeta kombëtare e duke pasur program për përparim; duke aktivizuar të gjitha vetitë dhe energjitet shpirtërore, si forca të domosdoshme organizuese kombëtare, në mënyrë që të mos mbetemi inferior i forcave që na rrethojnë!<sup>34</sup> Dhe jo pa qëllim ai thotë se “*unë, megjithatë, përfundimisht e munda veten...*”<sup>35</sup> Ky botëkuptim i tij vërteton thelbin e filozofisë së tij jetësore, se vizioni i harmonisë është i mundur dhe i zbatueshëm për aq sa ekziston uniteti i plotë i të kundërtave.

Për më tej, Demaci, në një nga ligjeratat e tij të shumta ai thot:

*“të gjitha objektet në mes të cilave ekziston një ndërveprim, janë në një vazhdimi të vetme hapësinore. Në këtë kuptim, ato përvèç që përfaqësojnë unitetin, secila ka interesa të veta në lidhje me diçka. Këto interesa mund të jenë të ndryshme, ashtu siç janë të ndryshme*

---

madhe, e dyta pas asaj të Rilindasit të parë – Naimit, e sendërtuar në mënyrë fare të thjeshtë e të prekshme, pa ngarkesa letrare, në rreshtat e këtij romani, e shndërron Demaçin në një Rilindas të dytë kombëtar. Ky roman është arsyjeja e burgosjes së tij të parë, gjë që e bën të palëkundur vendin e këtij romani jo vetë në historinë e letërisë shqiptare por edhe në historinë shqiptare në tërësi.

<sup>30</sup> Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, ishte organizata që u themelua nga Adem Demaçi, e cila më vonë u bë boshti kurrizor apo pikë reference e të gjitha organizatave që vepronin në hapësirën e robëruar shqiptare. Katër parimet esenciale të LRBSH janë: “Me qenë të bashkuar teritorialisht; Me pasë një treg të përbashkët ekonomik; Me pas një gjuhë të përbashkët letrare; Me qenë të përshkum nga ndjenjat e dashurisë, përkatësisë dhe solidaritetit reciprok vëllazërorë!” Përmes një analize të thjeshtë, këto katër parime ngërthejnë angazhimin për unitet të përbrendshëm si fazë e parë, për të kaluar në fazën e dytë të rezistencës aktive. Pra, filozofia e Demaçit, nga ky program politik del se nuk është statike, por evolutive, varësisht nga rrëthanat e krijuara.

<sup>31</sup> Selatin Novosella , intervistë në TV Klan Kosova, “Adem Demaçi është një njeri që ka flijuar gjithçka në jetën e tij, duke përfshirë edhe fëmijët, gruan e nënën”. Për më tepër:<http://klankosova.tv/zona-e-debatit-trefimi-per-adem-demacin-njeriun-e-kombit/>; Po ashtu, lexo: Adem Demaçi, “Dashuria kuantike e Filanit”, Prishtinë, 2007, f. 14.

<sup>32</sup> Adem Demaçi, “Dashuria kuantike e Filanit”, Prishtinë: Buzuku, 2007, f. 14.

<sup>33</sup> Po aty,fq. 14.

<sup>34</sup> Po aty,fq. 18

<sup>35</sup> Po aty, fq.228

*edhe objektet, të cilat janë të lidhur me njëra-tjetrën nëpërmjet kundërshtimit, me anë të luftës*".<sup>36</sup>

Ashtu si Herakliti<sup>37</sup>, Adem Demaçi e dinte se aty ku nuk ka përpjekje e angazhim aty nuk ka jetë. I mbështetur fort në këtë postulat, Demaçi, vizionin ideor e barti në rrafshin pragmatik, dhe arriti që konceptin e harmonisë, ta ngrisë në lëvizje historike, me bazë në të kundërtat.

Duke u nisur nga njëri prej parimeve të platformës së LRBSh, në të cilin theksohet “*me qenë të bashkuar territorialisht*”, Demaçi konceptin e harmonisë e sheh si të pandashëm nga koncepti i hapësirës në vlerën e saj. Mu këtu qëndron gjenialiteti, vlera e mendimit dhe qëndrueshmëria e filozofisë politike demaçiane, i cili duke iu kundërvënë një realiteti të hidhur dhe të zyrtë të popullit shqiptar, shtroi idenë se shpëtimi ynë domosdoshmërisht duhet të kalojë nga bashkimi në një shtet të vetëm.

Në këtë pikëpamje, Demaçi, lëvizjen historike e ngriti në lëvizje çlirimtare. Ky është shkaku që të gjitha lëvizjet historike në hapësirën shqiptare në ish-Jugosllavi, në gjysmën e dytë të shekullit XX e deri tek Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe së fundmi edhe pavarësia e Kosovës, janë të lidhura me frymëzimin, veprimtarinë dhe emrin e Adem Demaçit, sepse filozofia demaçiane para së gjithash është filozofi jetësore, po aq sa është politike. Këtë e shquajnë plot ngjyrime, në dukje të vogla e të ngashme me ato të shumë mendimtarëve, e që megjithatë, kjo si e atillë mbetet e veçantë dhe po aq e dallueshme nga të tjerat. Prandaj, duke zënë fill te filozofia e urtisë kombëtare, ajo merr tenin unik që e bën edhe të jetë autentike e *sui generis*.

Njohja e thellë e marksizmit, bënë që shumë studiues Demaçin ta radhisnin padiktueshëm dhe padrejtësisht në radhët e trashëgimtarëve më të mëdhenj revolucionarë botërorë.

Megjithëse në dukje i majtë me bindje politike, Demaçi që në fillim nuk përkrahte asnjërin nga modelet ekzistuese komuniste. Ai e dinte se nuk mund të bëhej aleat me askë në këtë ideologji, prandaj ai nuk përkrahte asnjërin nga modelet ekzistuese komuniste. Nga ana tjetër Demaçi kishte njohuri të thella mbi të djathtën politike, dhe shpesh herë këto njohuri atë e radhitën edhe si të djathët.

Tendenca për reduktimin e pikëpamjeve filozofike të Demaçit në të majtë apo të djathtë, duke u bazuar vetëm mbi bazën e shprehjeve ideologjike, i ngjajnë një thjeshtimi të papërligjur që nuk përfaqëson ndonjë thellësi mendimi, por bazohet vetëm në idenë sipërfaqësore se këto dy koncepte i referohen dy botëkuptimeve të kundërtat programore. Për më tepër, asnjëherë nuk ka ekzistuar një e majtë apo një e djathtë e vetme. Lidhur me këtë studiuesja Nadira Urbinati shkruan se “*ka shumë të majta dhe shumë të djathta, që kanë dallueshmëri të theksuar në mes vete*”<sup>38</sup>. Kjo pikëpamje është tërësisht e qëndrueshme sepse e majta e pas Luftës së Dytë Botërore ka qenë një e majtë e përcaktuar në kohë, ashtu siç ka ekzistuar një e djathtë e përcaktuar në kohë, e që kanë dallime thelbësore me të majtën apo të djathtën e më vonshme. Dallueshmëria në kohë nuk është i vetmi faktor

<sup>36</sup> Adem Demaçi, ligjeratë e autorizuar në Universitetin Vitrina”, Tiranë, 2011.

<sup>37</sup> Homeri “Iliada”, XVIII, fq. 107.

<sup>38</sup> Cfr. N. Urbinati, La sinistra vive se diventea un archipelago, “L’Unta”, 3 dhjetor 1993, pjesë të përkthyer nga Ramize Ferati.

ndarës. Hapësira poashtu është një nga faktorët tejet relevantë që i bën ato të papërshtatshme e të pazbatueshme. Një nga shembujt historikë është dështimi i zbatimit të teorisë marksiste në hapësirën e Lindjes së Mesme, në kohën e pas Luftës së Dytë Botërore.<sup>39</sup>

Si e majta, ashtu dhe e djaththa (organizatat ilegale me karakter çlirimtarë) në hapësirën shqiptare në ish-Jugosllavi, nuk kishin për bazë trashëgimin e të majtës apo të djathës të pas Luftës së Dytë Botërore. Ato, që të dyja, në hapësirën shqiptare, më së shumti kishin trashëguar elemente nga tradita dhe udhërrëfyesja kryesore, që ishte Rilindja Kombëtare. Andaj shumë herë, me të drejtë, lëvizja politike klandestine shqiptare e viteve '60 e këndej, konsiderohet si Rilindja e Dytë Kombëtare.<sup>40</sup>

Demaçi, duke përfshirë këtu edhe shumë bashkëmendimtarë, bashkëveprimtarë e dishepuj të tij, u dënuan me burg të rëndë, për pikëpamjet dhe bindjet e tyre politike, pikërisht nga e majta (marksiste-leniniste) jugosllave. Internacionalja komuniste nuk dha ndonjë përkrahje apo shqetësim për këtë. Nga ana tjetër, asnë nga organizatë me orientim të djathtë, qoftë në Europë apo në Ballkan, nuk e morën në mbrojtje personalitetin e Demaçit, deri në përfundim të sistemit ndërkombëtar bipolar. Shikuar nga ky prizëm, Demaçin nuk mund ta profilizojmë si ekskluzivisht si të majtë, ashtu siç nuk mund ta radhisim as si të djathtë.

Demaçi ecte në shtegun e tij, të dallueshëm si nga e majta, ashtu dhe nga e djaththa. Ai gjithnjë merrte përfundimet e veta, të cilat janë po ashtu aq të dallueshme e unike.

Për të ardhur deri te përkufizimi më i përafërt i filozofisë politike demaçiane, profilizimin e saj, në radhitet te filozofitë e majta apo të djaththa, të menduarit me diada<sup>41</sup>, do të ishte një udhërrëfyes që do i shërbente këtij studimi e përkufizimi.

Në rrashin politik ekzistojnë diada që janë antitetike<sup>42</sup> dhe komplementare. Të parat, bazohen në një bashkësi divergjente, të dytët në një botëkuptim konvergjent. Në raport me

<sup>39</sup> Marksizmi qe i parëndësishëm për Lindjen e Mesme meqenëse përbënte një teori ekonomike për shoqëri revolucioni post industrial. Në kohën e përhapjes së idesë marksiste, Lindja e Mesme ishte një shoqëri rurale e cila mbështetej në punën me dorë dhe bujqësinë tradicionale. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, marksizmi kurrë nuk u vendos në Lindjen e Mesme, përashto këtu Izraelin, ku u zbatua në masë të limituar. Pati lëvizje opozitare revolucionare që u vetëquajtën marksiste, por kurrë ndonjë qeveri, lëvizje politike apo edhe udhëheqës të promovojë marksizmin si sistem ekonomik.

<sup>40</sup> Albulena Halili "Viti i Ri serb dhe vetja ime kolektive", *PanAlbanica*, <http://panalbanica.net/2331/>

<sup>41</sup> Diada është bashkimi i të kundërtave. Në të gjitha disiplinat shkencore merren për bazë analiza gjithëpërfshirëse: në sociologji diada vendoset në mes të shoqërisë dhe bashkësisë; në ekonomi: tregu dhe plani; në teorinë e së drejtës: privatja dhe publikja; në estetikë: klasikja dhe romantikja; në filozofi: trashendenca dhe imananca; në politikë: e majta dhe e djaththa, por jo edhe e vëtmja, sepse në politikë shpeshherë nga diada kalohet në triadë, që nënkopoton bashkimin e të ndryshmeve dhe tetrada, që nënkopoton manifesimin e shqisave për elementet themelore si uji, zjarri, ajri, dhe dhei (pra të gjitha ato që perceptohen me shqisat tona).

<sup>42</sup> Antitetika (Greqisht antithesis - Kundërthënie): një proces metodik që bazohet në kundërshtimin e nocioneve dhe në kuptimin që të kundërtat bëjnë përmbytjen imanente të çdo procesi. Kante e quan antitezë transkendentale "hulumtim mbi antinomitë e mendjes së pastër, shkaqet dhe rezultatet e tyre" (Kritika e mendjes së pastër). Filozofia e përgjithshme e Hegelit është konceptuar në antitezat e termave duke formuar bazën për zbritjen (deduktimin) kategorike të saj. Në marksizëm, është po aq thelbësore që analiza e çdo procesi në natyrë ose shoqëri së pari zbulon kundërtëniet e brendshme si forcë lëvizëse.

doktrinat, si të majtat ashtu dhe të djathtat të cilat kishin për bazë totalitarizmin, Adem Demaçi mbështetet në diadën antitetike, ( në antitezën e atntitezës) . Në raport më marrëdhëniet përbrenda shqiptare, ai mbështetet në diadën komplemetare, e cila synonte afrimin e njëra-tjetrës, për të formuar një entitet të nivelit më të lartë nga dyja botëkuptimet. Kjo është rruga e tretë, për të cilën ai thoshte: “*Dy forca veprojnë mbi njëratjetrën dhe si rezultantë lind rruga e tretë që na çon drejtë lirisë...*”.<sup>43</sup>

E treta përfshirëse, priret të shkojë përtrej dy të kundërtave, duke i përmbledhur ato në një sintezë të epërme, pra, në të vërtetë duke i anuluar si të tilla.<sup>44</sup> Kjo ishte e treta e demaçiane, e tretë që nuk ishte përjashtuese, por përfshirëse, e tretë që eliminonte divergjencat e skajeve dhe ofronte pjesët e pajtueshme nga dyja palët e kundërtta. Në praktikë, politika e rrugës së tretë paraqitet si një politikë e qendrës dhe shpesh herë nënkuptohet jo si një formë kompromisi, por si kapërcim i të dy skajeve dhe njëkohësisht si asgjësim i tyre. Tek e treta demaçiane në vend që të ndahan dy skajet nga njëra tjetra, përkundrazi, ato afrohen dhe suprimohen në një amalgamë ideologjike. Amalgama ideologjike që ai synoi të krijojë dhe që në fund ia arriti, duke bashkuar dy botëkuptimet ideologjike shqiptare: botëkuptimin e majtë dhe botëkuptimin e djathtë, është thelbi i filozofisë politike demaçiane.

E treta përfshirëse, për dallim nga e treta e përfshirë që është një praktikë në kërkim të një doktrine, është doktrinë në kërkim të një praktike.<sup>45</sup> Filozofia e Demaçit është unike sepse i ka të dyjet: doktrinën dhe praktikën. Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve e cila u themelua mbi këtë frymë dhe i fryshtëzoi të gjitha organizatat atdhetare ilegale, me karakter çlirimtarë, të ecnin mbi këtë filozofji, ndaj me të drejtë ajo mund të emërohet “Filozofia demaçiane e Amalgamës ideologjike shqiptare”.

### Bibliografia:

Adem Demaçi “Gjarpërinxhje e gjakut”, Buzuku, 1990

Adem Demaçi, “Dashuria kuantike e Filanit”, Prishtinë: Buzuku, 2007

Adem Demaçi, ligjeratë e autorizuar në Universitetin Vitrina”, Tiranë, 2011

Declaration on the Granting of Independence to Colonial Countries and Peoples, Adopted by General Assembly resolution 1514 (XV) of 14 December 1960

Hakif Bajrami, Epoka e Demaçit,

Homeri “Iliada”

Selatin Novosella , intervistë në TV Klan Kosova

<http://klankosova.tv/zona-e-debatit-rrefimi-per-adem-demacin-njeriun-e-kombit/>

Cfr. N. Urbinati, La sinistra vive se diventea un archipelago, dhjetor 1993

PanAlbanica

<http://panalbanica.net/>

Platforma e Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, 1964

<sup>43</sup>Adem Demaçi “Dashuria kuantike e Filanit”, op.cit, fq.149.

<sup>44</sup>Norberto Bobbio, “E majta dhe e djaththa: gjykime dhe kuptime të një dallese politike”, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 1997, fq. 11-17.

<sup>45</sup>Po aty.

Norberto Bobbio, “E majta dhe e djathta: gjykime dhe kuptime të një dalles politike”,  
Instituti i Dialogut&Komunikimit, Tiranë, 1997  
Ulter Laker, Evropa në Kohën ,Tiranë, 1996  
Demostratat e vitit 1968, Vëllimi I, Instituti Albanologjik i Prishtinës & Shoqata e Të Burgosurve Politik, Prishtinë 2012.  
J.B. Duroselle, Europe and the History of its Peoples, Viking, 1990.  
ADEM DEMÇI- Ura mbi të cilën kalon liria e Kosvës.  
J.B. Duroselle, Europe and the History of its Peoples, Viking, 1990.